

ELISA SPIROPALI

Kryetare e Kuvendit të Republikës së Shqipërisë

Jetëshkrimi:

Znj. Elisa Spiropali është zgjedhur Kryetare e Kuvendit të Republikës së Shqipërisë gjatë Legjislaturës X, prej 30 korrikut 2024.

Znj. Spiropali ka një karrierë të spikatur politike, parlamentare dhe qeverisëse.

Prej janarit 2019 deri në korrik 2024, ka shërbyer si ministre e Shtetit për Marrëdhëniet me Parlamentin, duke u riemëruar në mandatin e tretë qeverisës të Partisë Socialiste, në shtator 2021.

Znj. Spiropali po shërben në mandatin e dytë si deputete e Kuvendit të Republikës së Shqipërisë. Në zgjedhjet parlamentare të vitit 2017 është zgjedhur deputete e Qarkut të Korçës, ndërsa në zgjedhjet e vitit 2021 është zgjedhur deputete për Qarkun e Tiranës.

Para emërimit në detyrë si Ministër Shteti për Marrëdhëniet me Parlamentin, znj. Spiropali ka mbajtur funksionin e nënkryetares së Grupit Parlamentar Socialist dhe të nënkryetares së Komisionit për Punën, Çështjet Sociale dhe Shëndetësinë, prej vitit 2017 deri në vitin 2019.

Znj. Spiropali ka një karrierë të spikatur në Partinë Socialiste, ku bën pjesë prej vitit 2009. Është anëtare kryesie dhe drejtuese politike në Partinë Socialiste.

Znj. Spiropali ka një formim solid dhe ekselent akademik dhe universitar.

Ka kryer dy vitet e para të shkollimit të mesëm në gjimnazin "Qemal Stafa" në Tiranë për të vazhduar më pas në "*Lester B. Pearson College*", *United World College (UWC) of the Pacific*, në Kanada, pasi fitoi bursën si një nga pesë gjimnazistet më të mira në Shqipëri.

Pasi fitoi Bursën në "*Mount Holyoke College*" (2001), ndoqi studimet e larta në Massachusetts, SHBA ku u diplomua në vitin 2005 me dy tituj nderi në dy degë universitare Ekonomi (*Economics*) dhe Politikë (*Politics*). Një semestër e kreu në Buenos Aires, në programet e shkëmbimit me bursë ekselence nga Universiteti "*Mount Holyoke College*" për studimin e krizës ekonomike argjentinase.

Në vitin 2007 fitoi bursën "*Chevening/OSI*" për studime pasuniversitare në *Contemporary Europian Polícts*, në Universitetin "*Sussex*" në Britaninë e Madhe.

Znj. Elisa Spiropali është lindur në Tiranë, më 15 mars 1983.

Ajo është e martuar dhe jeton në Tiranë, me bashkëshortin, Salarjonin, dhe dy fëmijët, Naltën dhe Krenin.



ELISA SPIROPALI

Speaker of the Parliament of the Republic of Albania

Biography:

Mrs. Elisa Spiropali was elected Speaker of the Parliament of the Republic of Albania during the X Legislature, since 30 July 2024.

Mrs. Spiropali has a prominent political, parliamentary and governmental career.

From January 2019 to July 2024 she served as Minister of State for Relations with Parliament, being reappointed, in September 2021, in the third governing term of the Socialist Party.

Mrs. Spiropali is serving in her second mandate as Member of the Parliament of the Republic of Albania. In the 2017 parliamentary elections she was elected as a representative of the Korça District, while in the 2021 parliamentary elections was elected as a representative of the Tirana District.

Prior to her appointment as Minister of State for Relations with the Parliament, Mrs. Spiropali held the position of the Deputy Chair of the Socialist Party Parliamentary Group and Deputy Chair of the Committee on Labor, Social Issues and Health, from 2017 to 2019.

Mrs. Spiropali has a prominent career in the Socialist Party, being a member since 2009. She is a member of its leadership and is also a political leader in the Socialist Party.

Mrs. Spiropali has a solid and excellent academic and university background.

She attended for two years the “Qemal Stafa” Gymnasium in Tirana to then continue in the “Lester B. Pearson College”, United World College (UWC) of the Pacific, in Canada, as she won the scholarship as one of the top five high school students in Albania.

After winning a scholarship from “Mount Holyoke College” (2001) she continued her university studies in Massachusetts, USA where she graduated in 2005 with two honorary degrees in Economics and Politics. She completed one semester in Buenos Aires, as part of an exchange program, with a merit scholarship from “Mount Holyoke College” University to study the Argentinean economic crisis.

In 2007 she won the “Chevening/OSI) scholarship for postgraduate studies in Contemporary European Politics, at the University of Sussex in Great Britain.

Mrs. Elisa Spiropali was born in Tirana, on 15 March 1983.

She is married and lives in Tirana, with her husband, Salarjon, and their two children, Nalta and Kren.